



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Procesverbal

nga takimi publik me qytetarë i mbajtur më 22 dhjetor 2022

Takimi filloi në orën 10.20

Takimin publik e hapi dhe e kryesoi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës.

Në takim ishte i pranishëm një numër i konsideruar i qytetarëve (32 pjesëmarrës);

Nënkryetarja e Komunës, Drejtorët e Drejtorive të Administratës së Komunës, përfaqësues të KFOR-it, të OJQ-ve dhe mediat.

Tema:

Realizimi i projekteve dhe aktiviteteve tjera të parapara për vitin 2022

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, të respektuar qytetarë, e respektuara Nënkryetare dhe Kryesues i Kuvendit dhe Drejtorë të Drejtorive dhe të gjithë ju të pranishëm. Qytetarë të nderuar fillimisht ju falënderojë për kohën dhe pjesëmarrjen e juaj në këtë takim, në paraqitjen e Raportit të punës për vitin 2022, ku do të fillojmë sipas Drejtorive me paraqitjen e punëve dhe aktiviteteve më kryesore që i kemi bërë gjatë kësaj periudhe një vjeçare që edhe ashtu jemi në përmbyllje të vitit kalendarik dhe buxhetor. Atëherë të fillojmë sipas Drejtorive;

Drejtoria e Administratës

Është Drejtoria që është kujdesur për të gjitha punët administrative në kuadër të fushëveprimit të administratës komunale. Viti 2022 ishte vit i cili ka ofruar mundësinë e ofrimit të shërbimeve për kërkesat dhe pagesën e tarifave për regjistrimin e automjeteve vetëm përmes një sporteli, në mënyrë që qytetarët të mos lëvizin për kryerjen e këtyre shërbimeve, pastaj është bërë edhe freskimi i shërbimeve, këtu kam parasysh faktin që gjatë kësaj periudhe kohore kemi bërë tërheqjen e atyre zyrtarëve të cilët kanë qenë në moshë më të rinj nga periferitë ku kanë kryer shërbimet e tyre, duke i sistemuar në objektin e administratës komunale, për faktin që kanë qenë më ekspeditiv në kryerjen e punëve dhe shërbimeve. Projekt tjetër i kryer gjatë këtij viti është digjitalizimi i sallës ku jemi tani. Ne kemi pas të kontraktuar televizionin lokal për incizimin e mbledhjeve të Kuvendit por edhe të takimeve tjera, ku edhe kemi shpenzuar një shumë të konsideruar të mjeteve financiare për incizimin qoftë të mbledhjeve të kuvendit, qoftë të mbledhjeve tjera, por nganjëherë televizioni filloi të luante rolin e opozitës duke na goditur herë pas here. Kështu që duke marrë parasysh edhe shpenzimet dhe shërbimet për të cilat nuk ishim të kënaqur, atëherë vendosëm të bëjmë digjitalizimin e kësaj salle të mbledhjeve dhe e njëjta është e mbuluar me sistemin e kamerave ku mbledhjet transmetohen në video incizime online, ku takimet përcjellën pa kurrfarë pengese. Kemi bërë freskimin e E-kioskave ku kryhen shërbime për qytetarët, ku në këtë vit janë pajisur me një softuer të ri dhe janë shumë më efikase se sa deri më tash që kanë funksionuar. E-kioskot bukur shumë e kanë lehtësuar punën e administratës sepse funksionojnë 24/7. Në veçanti kemi marrë shumë lëvdata për E-kioskën i cili funksionon në pikën kufitare në Merdar për arsye se ajo është në dispozicion për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të cilët kalojnë përmes këtij vendkalimi kufitar. Gjithashtu punë e mirë është bërë me mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike qoftë të zyrave të gjendjes civile në

terren me qëllimin e vetëm të kemi shërbime sa më të mira dhe më të avancuara për qytetarët tanë. Këtë vit e kemi liruar edhe autoparkun e Komunës i cili ka qenë i stërbushur me disa makina të vjetra të cilat për vite të tëra kanë dalë jashtë funksionit, kështu që i kemi shitur përmes një ankandi publik. E njëjta gjë kanë ndodhë edhe me lirim/shitjen përmes ankandi e disa pajisjeve të cilat kanë qenë brenda përbrenda objektit të Komunës dhe që faktikisht nuk kanë qenë në shërbim. Vlen të theksohet se qëndrojmë keq me objektin e vjetër të Komunës. Ne kemi filluar disa investime atje me renovimin e objektit të vjetër, në veçanti për hapësirën për bibliotekën e qytetit, por siç duket kemi bërë një hap pak të ngutshëm, kemi bërë disa veprime pa marrë leje paraprakisht nga institucioni përkatës i cili e menaxhon, për arsye se objekti kishte qenë i mbrojtur si trashëgimi kulturore, prandaj aty i kemi disa pengesa me Agjencinë për trashëgiminë kulturore dhe deri sa të tejkalojmë atë nuk kemi arritur për të zhvendosë bibliotekën e qytetit në atë pjesë të objektit. Çështje tjetër është se në atë objekt është duke u shfrytëzuar një numër i zyrave, e që disa kanë qenë duke u shfrytëzuar edhe më parë, ndërsa ne i kemi dhënë në dispozicion disa prej tyre OJQ-ve të ndryshme dhe besoj se duhet të bëjmë një risistemim më të mirë në mënyrë që atë objekt ashtu si është në këto kushte të funksionalizohet dhe shfrytëzohet në mënyrë sa më racionale. Besoj se në vitin 2023 do na mbetet të qëndrojmë pak më shumë me Drejtorinë e Administratës në objektin e vjetër për të bërë një risistemim më të mirë.

Drejtoria e Buxhetit dhe Financave

Po ashtu ka kryer punët dhe detyrat në kuadër të fushëveprimit të saj. Është planifikuar dhe aprovuar buxheti i Komunës për vitin 2023, buxhet i cili është më i larti në historikun e pas luftës së Komunës së Podujevës, ku kap vlerën 27,46587 €, buxhet i cili është më i lartë rreth 4 mil. më i lartë se buxheti i vitit 2022, e që është një sinjal i mirë sepse do të kemi mundësi për realizimin e më shumë projekteve për qytetarët tonë. Është bërë tejkalmi i të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2022, në vlerë rreth 500,000 €, e kjo është një sinjal se po punohet mirë. Nëse kemi tejkalm të realizimit të hyrave vetanake do të thotë se kemi krijuar një disiplinë financiare, borxhlinjtë po i përmbushin borxhet, ndërsa ne kryejmë shërbimet me mundësitë dhe kapacitetet që i kemi. Shuma prej 500,000 € do të shfrytëzohet për fillimin e ndërtimit të objektit të SHME “Isa Boletini”. Ky kompleks synohet të shkojë në kompleksin e shkollave të mesme, në një farë forme ta kemi një kompleks të shkollave të mesme brenda përbrenda një hapësire, ndërsa objekti aktual i SHME do të shndërrohet në një shkollë fillore ku do të krijohet mundësia për lirimin e dy objekteve shkollore në qendër, siç janë “Shaban Shala” dhe “Naim Frashëri”, në veçanti shkollën “Naim Frashëri” sepse jemi të detyruar të punojmë me tri ndërrime. Pra ai objekt do të na krijojë mundësi më të mirë, të lirohen këto dy objekte shkollore por edhe ta kemi një objekt të ri të shkollës fillore brenda qytetit të Podujevës.

Çështje me rëndësi që vlen të theksohet është raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit, sipas të cilit Komuna e Podujevës ka vlerësim pozitiv për menaxhimin e financave publike. Pas një kohe bukur të gjatë kemi raport të pakualifikuar që d.m.th. menaxhimi dhe shpenzimi i buxhetit komunal është i mirë dhe me vlerësim pozitiv. Gjatë vitit 2022 janë regjistruar në sistemin e tatimit në pronë afër 400 objekte të reja të cilat normal kanë pasur ndikim pozitiv në rritjen e të hyrave vetanake. Ndoshta dikush mund të shtrojë pyetje se nga erdhën 400 objekte të reja. Kemi pas një numër të madh të ekonomive familjare por edhe të bizneseve të cilat për vite të tëra kanë qenë jashtë tatimit në pronë dhe arsyet mund t’i dinë ata që kanë qenë në qeverisje para neve, ne nuk jemi në dijeni pse kanë mbetur të tilla. Fatkeqësisht kemi pas edhe disa biznese bukur në zë të cilat nuk kanë qenë të regjistruara dhe ne në saje të punëve të mira që i kemi bërë po arrijmë që gradualisht të gjithë ata që kanë obligime tatimore ndaj Komunës t’i fusim në sistem të tatimeve.

Drejtoria e Arsimit, gjatë këtij viti ka kryer një varg detyrash dhe punësh në kuadër të fushëveprimit të saj. Vlen të theksohet se është viti i parë që është filluar me shujta të fëmijëve prej klasës së parë deri në klasën e pestë. Është një investim të cilin e bënë Ministria

e Arsimit dhe faktikisht kjo kategori e fëmijëve furnizohen me këto shujta ditore, është projekt i cili është duke u realizuar mirë dhe pa probleme dhe besoj që sadopak e ulë diferencën e fëmijëve të cilët mund të kenë dallime në kuptim të çështjes ekonomike familjare, për arsye se tani pak a shumë kanë një furnizim të një trajtshëm dhe të gjithë ndihen pak a shumë të barabartë. Janë furnizuar shkollat me inventar në vlerë financiare 140,000 €; Dy shkolla janë furnizuar me kabinete të TIK-ut; Njëmbëdhjetë shkolla janë bërë me kabinete të shkencave natyrore; Janë krijuar 6 qendra të lojërave për fëmijë; Është hapur çerdhja e dytë publike dhe kjo pas 22 viteve dhe kjo është bërë më shpejtë dhe na duhet edhe pak punë dhe do ta kemi edhe çerdhen e tretë publike në fshatin Lluzhan. Vitin që vjen e kemi të planifikuar edhe çerdhen publike në fshatin Batllavë dhe kjo është buxhetuar prej Ministrisë së Arsimit, por ndoshta do të orientohemi edhe nga fshati Kërpihem, përkatësisht fshati Dobërdol, ku e kemi një objekt i cili pothuajse është i gatshëm. Me qëllim të rritjes së sigurisë nëpër shkolla kemi bërë instalimin e kamerave në 14 institucione shkollore dhe tashmë e kemi një siguri më të mirë brenda përbrenda objekteve shkollore dhe kjo shërben edhe për nxënës por edhe për sigurinë fizike të objekteve shkollore. Njëzet shkolla janë pajisur me piano ku tashmë mësimdhënësit e muzikës kanë mundësi që një pjesë të punës së tyre ta bëjnë praktikisht. Këtë vit kanë filluar punimet në ndërtimin e shkollave fillore në fshatrat Obrancë dhe Lluga, ku shkolla në fshatin Lluga financohet prej Ministrisë së Arsimit dhe është projekt dyvjeçar, ndërsa shkolla në fshatin Obrancë është duke u financuar me buxhetin komunal. Ka filluar ndërtimi i sallave të sportit në shkollat fillore “Naim Frashëri” dhe “Enver Maloku”. Janë nënshkruar disa marrëveshje me kompanitë vendore për realizimin e punës praktike me nxënës të shkollave të mesme ku janë duke i realizuar punët praktike. Pak iu kompensohet atyre nxënësve për punën praktike që e bëjnë dhe në një formë është një bashkëpunim mes bizneseve dhe shkollave tona, sepse e kemi dhënë si premtim se kemi për të zgjeruar realizimin e kësaj praktike. Është realizuar projekti i financuar nga Ambasada Japoneze për pajisjen e shkollës teknike me mjete moderne për fushat të cilat i mbulon. Shkolla SHMLE “Naim Frashëri” është pajisur me mjete të kabinetit të muzikës, e me mjete të njëjta është pajisur edhe SHMLE “Luigj Gurakuqi” në fshatin Batllavë. Këto kabinete janë projekt i IOM-it që mbulojnë fushën e muzikës dhe të shkencave natyrore dhe ndërlidhet me komunitetet jo shumicë dhe në të dy këto shkolla kemi nga disa nxënës të komunitetit ashkali. Këtë vit fshatrat Balloc dhe Batllavë janë bërë me shkolla të reja, një palestër e sportit në fshatin Batllavë. Ka filluar renovimi i 7 shkollave për efikasitet, projekt i cili është financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, por edhe nga Banka Botërore dhe Bashkimi Evropian, dhe në një prej atyre objekteve shkolla “Shaban Shala” ku dje ishim në përrurim, dhe sa për informim kjo shkollë sa i përket kushteve për punë ka qenë në gjendje bukur të rëndë, ndërsa tani kemi një shkollë moderne, të izoluar dhe fasaduar dhe me kulm të ri, ku janë krijuar kushtet të kemi një efikasitet relativisht të lartë të energjisë. Shkolla teknike është furnizuar me kabinete profesionale të rrobaqepësisë, arkitekturës por edhe kabinet për përpunimin e drurit. Është nënshkruar marrëveshja me Ministrinë e Arsimit për themelimin e Qendrës së Karrierës në shkollën e mesme profesionale “Fan S. Noli” dhe është duke u punuar për të bërë funksionale këtë Qendër.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Po ashtu ka realizuar një varg punësh dhe projektesh në kuadër të kësaj Drejtorie. Ka filluar ndërtimi i objektit të urgjencës së qytetit i cili kap vlerën rreth 1.7 mil euro, projekt në bashkëfinancim me Katarin dhe do të jetë një objekt prej më bashkohorëve, i cili do të jetë i kompletuar me aparaturat e nevojshme për punë. Është bërë funksionalizimi i QMF së re në fshatin Lluzhan dhe kjo na ka krijuar mundësinë që objektin aktual të shndërrojmë për çerdhe publike, ku do të kryhen edhe disa meremetime të vogla dhe do të jetë e gatshme për punë. Kanë përfunduar punimet fizike në AMF në fshatin Gllamnik dhe jemi duke pritur të bëhet inventarizimi, të funksionalizohet dhe të kthehet në shërbim të qytetarëve. Është bërë digjitalizimi i mamografit dhe i rendgenit në QKMF. Në QMF në fshatin Lluzhan tani e tutje

do të bëhen të gjitha analizat biokimike dhe hematologjike sikurse në QKMF – Podujevë. Është një furnizim i rregullt me barëra dhe reagensa dhe nuk besoj se ka ndonjë QMF në nivel vendi që ka furnizim më të mirë në raport me kërkesat dhe nevojat që janë për qytetarë. Ju jeni në dijeni se nuk është largët në kohë që edhe gjilpërat është dashur të blihen dhe tani jo vetëm që nuk është duke ndodhur diçka e tillë, por kemi filluar dhe zgjeruar një varg shërbimesh tjera, sikurse rasti i shërbimit paliativ. Është pranuar një donacion nga Banka Botërore me pajisje mjekësore defibrilator dhe monitor AED. Janë subvencionuar me mjete financiare 704 familje në shumë financiare 94,550.00€ , ndërsa OJQ-të janë përkrahur me mjete financiare në shumë 20,000 €. Me fondacionin “Shqiptarët për Shqiptarët“ jemi duke e bërë ndërtimin e 22 shtëpive për familjet nevojtare në Podujevë, ndërsa vlera e projektit është afërsisht 1 mil euro. Tashmë shtëpitë veç se janë të gatshme, ndërsa neve si institucione komunale na ka mbetur që të rregullojmë infrastrukturën dhe ambientin e jashtëm. Në bashkëfinancim me Katarin janë hap 79 puse për ujë të pijshëm për familjet nevojtare, ku ka kërkesa bukur shumë për hapjen e këtyre puseve dhe falë një bashkëpunimi të mirë me Katarin çdo vit kemi realizim të një numri të madh të puseve. Në bashkëfinancim me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” në Komunën e Podujevës janë ndërtuar 20 shtëpi për familjet me asistencë sociale për çka dfuhet falënderuar z. Halil Kastratin dhe shoqatën e tij që në të vërtetë na kanë ndihmuar shumë në zgjedhjen e këtyre problemeve. Janë ndihmuar 1272 familje me pako ushqimore dhe higjienike nga donatorët, shoqatat dhe organizatat e ndryshme humanitare.

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Është Drejtori e cila ka kryer punët dhe detyrat në kuadër të fushëveprimit të saj. Një kohë relativisht të gjatë është përfol që Komuna nuk e ka realizuar Hartën Zonale dhe për shkak nuk po mund të ndërtojnë në qytetin e Podujevës. Tashmë kjo çështje është zgjedh, ne kemi bërë miratimin e Hartës Zonale dhe jemi në pritje të investitorëve që dëshirojnë të vijnë dhe të investojnë në Komunën tonë. Harta Zonale është për periudhën 2022-2030. Kemi filluar punët në rikonstruimin e rrugës “ Skënderbeu” që është një projekt në vlerë 1.4 mil euro, është një rrugë që ka për të qenë e kompletuar. Qytetarët herë herë po theksojnë se nuk kemi bërë zgjerimin e rrugës, sa për dijeni, nuk ka qenë qëllimi i zgjerimit të rrugës, qëllimi ka qenë rikonstruimi në po të njëjtin dimension, vetëm se kësaj rruge i shtohet traseja e biçikletave, trotuari dhe ndriçimi publik dhe normal edhe infrastruktura nëntokësore. Gjatë këtij viti në fshatrat dhe qytetin e Podujevës kemi asfaltuar rreth 40 km, ku janë lidhur 18 kontrata për realizimin e këtyre projekteve. Është bërë meremetimi i objekteve banesore në qytet. Përmes Ministrisë përkatëse janë vënë në mbrojtje dy objekte që i takojnë grupit të objekteve natyrore dhe atë “Ushton Lumi” dhe “Trungu i Qarrit” të cilët do të jenë në mbrojtje të institucioneve. Janë trajtuar gjithsej 441 lëndë për legalizim dhe leje ndërtimi. Është hartuar draft rregullorja për bonuse të zonimit dhe ne jemi komuna e parë që kemi avansuar diçka në këtë aspekt dhe disa prej komunave janë duke e marrë si shembull Komunën tonë, dhe kjo është bërë falë angazhimit të Drejtorit të DPUMM me ekipin e vet dhe unë besoj se së shpejti kjo draft Rregullore do të procedohet në Kuvend për miratim.

Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë

Gjatë kësaj periudhe kohore ka trajtuar gjithsej 2666 lëndë të ndryshme, ku përfshijnë shitblerje, dhurim, trashëgimi, ndarjen fizike, këmbime, ndërmjetësime, qira mbajtje, historiat, korrigjim, regjistrime të hipotekës. Në sektorin e pronës janë trajtuar 109 lëndë, e që kanë të bëjnë me aktvendimet mbi uzurpimet, njoftim për lirim të pronës, shndërrim të pronës nga private në komunale dhe ekzekutim të vendimeve. Po ashtu kjo drejtori ka kompletuar gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shpronësimet e pronave, për pronat me interes për projektet të cilat Komuna planifikon ti zbatojë në vitet në vazhdimësi, është fjala për shpronësimet që janë bërë për varrezat në hapësirën në fshatin Obrançë, që do të jenë varrezat e qytetit të Podujevës, por edhe hapësirat që lidhen me infrastrukturë tjetër të nevojshme duke filluar prej

zonës industriale që do të ndërtohet, dhe për pjesë tjera të infrastrukturës për nevoja të Komunës.

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sport

Ka përmbyllur renovimin dhe hapjen e galerisë së arteve dhe nesër do ta kemi edhe zyrtarisht përrurimin e këtij objekti me një ekspozitë, për çka po shfrytëzoj rastin të ju ftojë publikisht të jeni pjesë e atij eventit që do të bëhet nesër, e që edhe ashtu është publik informacioni. Ka përfunduar restaurimi i objektit të bibliotekës së qytetit, presim që t'i tejkalojmë pengesat të cilat i paraqita më herët dhe në vitin 2023 ta hapim bibliotekën e qytetit. Është bërë ndërtimi i një fitnesi të hapur në Parkun e qytetit. Janë vazhduar punët me ndërtimin e stadiumit të futbollit në fshatin Peran, i cili është në fazën fillestare dhe presim përmbylljen e këtij projekti, sepse janë dal disa probleme teknike në fund, me barin (bari i ish fushës së futbollit të Stadiumit të qytetit) që duhet të vendoset, por shpresojmë që do të tejkalojmë këtë problem. Janë përmbyll projektet në ndërtimin e fushave të reja të futbollit dhe basketbollit në fshatrat Surkish, Lupç, Siboc, Bajçinë dhe Gllamnik. Në fshatin Siboc është sipas planifikimeve që ka ndodhë shumë më herët sepse ne nuk do ta planifikonim ashtu, ngase kur ka vërshime po dëmtohet fusha sepse ka qenë edhe projekti i tillë, fusha është mbuluar me bari sintetik dhe kjo nuk është në rregull, por po shpresojmë ta zgjidhim këtë problem. Meqë projekti ka qenë i planifikuar shumë më herët që të realizohet si i tillë ne nuk kemi mundur të ndërhyjmë, sepse tani pas vërshimit ka marrë pamjen e liqenit nga uji. Unë isha shumë i interesuar që në vend të këtij bari sintetik ta ndërtojmë fushën sportive me asfalt, mirëpo ishte shumë vonë për ta bërë këtë ndryshim dhe u detyruam të vazhdojmë me projektin, mirëpo na mbetet të investojmë në rregullimin e shtratit të lumit, për të ngritur ndonjë pengesë, në mënyrë që mos të rrezikohet fusha nga vërshimet. Është caktuar lokacioni për ndërtimin e pishinës së mbyllur gjysmë olimpike në afërsi të ish hotel Besianës, në pjesën e dytë të parcelës që planifikohet për ndërtimin e urgjencës së qytetit. Është realizuar marrëveshja me Ministrinë e Kulturës për ndërtimin e qendrës multifunkionale në vlerë 1,100,000.00 €, ku Komuna do të participojë me 100,000.00 €, ndërsa pjesën tjetër do ta financoj Ministria e Kulturës, projekt i cili është shumë i rëndësishëm për komunën tonë, mirëpo kemi disa probleme rreth lokacionit për arsye se brenda hapësirës së qytetit nuk kemi parcela apo hapësira të mjaftueshme të komunës por kemi hapësira pronësore në periferi të qytetit. Meqenëse ka filluar ndërtimi i stacionit të autobusëve do të bëhet zhvendosja e stacionit aktual të autobusëve dhe do i shohim mundësit që tregun aktual që nuk është duke funksionuar ta zhvendosim në hapësirat e stacionit të autobusëve pastaj hapësirën e tregut do e shohim si variant për ndërtimin e qendrës multifunkionale. Në kuadër të investimeve në trashëgiminë kulturore është në përfundim restaurimi i projektit të shkollës së vjetër në fshatin Sfeçël, ku janë ndarë 52,000.00 €, për ruajtjen e vlerës trashëgimore të këtij objekti shkollor, ndoshta do e destinojmë këtë objekt për ndonjë aktivitet që ju nevojitet qytetarëve. Biblioteka e qytetit është pasuruar me 950 tituj të librave me 3000 kopje, ku një pjesë relativisht e madhe e këtyre librave janë dhuruar nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit. Kemi investuar në një projekt të vogël për vendosjen e emblemave të UÇK-së, në memorialin e dëshmorëve në fshatin Penuhë, besoj se e kemi parë emblemën e UÇK-së në hyrje të memorialit të dëshmorëve dhe në bashkëpunim me shoqatat e dala nga lufta kemi marrë përsipër realizimin e këtij projekti. Gjithashtu është bërë subvencionimi i projekteve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit në shumë prej 13,280.00 €, kemi bërë subvencionimin e klubeve sportive në vlerë rreth 40,000.00 €, subvencionimin e projekteve teatrore në vlerë 31,000.00 €. Kemi arritur që të sjellim agjent të njohur të futbollit nga klube të ndryshme nga Anglia por edhe nga Gjermania me qëllim të gjetjes së mundësive për të parë talentët tanë dhe eventualisht ndonjërit prej tyre t'i krijohet mundësia që të lëvizin dhe të krijojnë karrierën e tyre në të ardhmen. Janë dhënë 4 premiera të shfaqjeve që janë subvencionuar nga Komuna e Podujevës në Teatrin e Qytetit "Avdush Hasani", ku janë realizuar 25 shfaqje teatrale. Janë shënuar ngjarje të ndryshme të datave historike për vendin

dhe Komunën tonë, gjithashtu janë mbajtur manifestime të ndryshme kulturore, artistike dhe sportive gjatë këtij viti.

Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim

Ka realizuar një numër të projekteve në interes të qytetarëve siç është ndërtimi i trotuareve në qytet dhe fshatra në gjatësi 8.8 km gjatë këtij viti. Janë ndërtuar rreth 25 km ndriçim publik, projekt i cili nëse e shohim në gjatësi është më i vogël këtë vit për arsye se ky vit ka qenë vit me probleme sa i përket furnizimit me energji elektrike, gjithashtu varësisht furnizimit të energjisë elektrike dhe në mungesë të saj ne kemi planifikuar edhe ndërprerjen e ndriçimit publik aktual me qëllim të kursimit të energjisë elektrike mirëpo deri më tani nuk kemi pas ndonjë problem të tillë dhe besojmë se vitin e ardhshëm do i rrisim investimet në shtrirjen e rrjetit të ndriçimit publik në lagjet dhe vendbanimet e Komunës së Podujevës. Kemi bërë zgjerimin e shtretërve të lumenjve dhe përroskave, janë ndërtuar kaskadat në Lumin Llap brenda qytetit të Podujevës, janë ndërtuar muret mbrojtëse të lumit Llap në gjatësi 980 m dhe rrjedhave tjera me gabion. Është bërë riparimi i rrugëve të asfaltuara përafërsisht janë riparuar rreth 4628 m² të rrugëve të asfaltuara. Është bërë rregullimi i infrastrukturës së varrezave në qytet dhe fshatra ku kemi ndërtuar rrethojë siç e kemi rastin në fshatrat Gllamnik dhe Llaushë. Janë krijuar një mori parkingjesh, është bërë ndërtimi i rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik në qytet dhe fshatra ku janë ndërtuar në gjatësi rreth 9500m, brenda hapësirave të ndryshme të komunës. Është bërë ndërtimi i urave dhe kalesave në fshatrat Pakashticë e Epërme, Repë, Popovë, Llugë, Pollatë, Brecë, Dobërdol, janë ndërtuar 9 ura, një urë për këmbësor dhe 4 pllaka të urave janë vendos, ka vazhduar ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni me gjatësi 2578 m, po ashtu kemi ndërtimin e disa kalesave të urave, trotuareve dhe ndërtimin e urave të vogla për këmbësor. Kemi arritur që ta realizojmë me sukses dhe pa problem të bëjmë mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë stinës së dimrit për vitet 2021-2022, që kemi pas një mirëmbajtje solide, po ashtu për vitin 2023 kemi lidhur dy kontrata me dy kompani për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë stinës së dimrit. Kemi bërë largimin e deponive ilegale, gjithsej kemi larguar 41 deponi ilegale dhe kemi vazhduar me trajtimin e projektit për qenët endacak, ku janë trajtuar mbi 300 raste, projekt i cili paraqet vështirësi për realizimin e tij sepse për kundër të gjitha punëve dhe veprimeve që kemi ndërmarr prapë se prapë kemi relativisht një numër të madh të qeneve endacak në fshatrat dhe qytetin e Komunës së Podujevës. Janë mbjellë 1214 drunjë dekorativ dhe 120000 lule të reja brenda hapësirave të qytetit gjatë periudhës së stinës së verës. Në kontratën për mirëmbajtjen dhe pastrimin e lumenjve, janë pastruar dhe zgjeruar hapësira të shtretërve të lumenjve në gjatësi 8235m, ndërsa janë trajtuar shtretërit e lumenjve me gurë në gjatësi 4600m. Në bashkëpunim me kompanitë e kontraktuara kemi bërë larjen e rrugëve dhe trotuareve, shesheve dhe gjelbërimit të hapësirave në qytet, gjithashtu kemi kryer edhe shumë punë tjera që rrjedhin sipas kontratës së lidhur me KRM-Pastrimi. Është bërë vendosja dhe dislokimi i kamerave në 12 pjesë të qytetit dhe 4 kamerave tjera në qytetin e Podujevës me qëllim të rritjes së sigurisë për qytetarët tanë. Po ashtu kemi vepruar në shumë raste në kuptimin e mirëmbajtjes së ndriçimit publik, ku përafërsisht kemi bërë 347 intervenime në rregullimin e ndriçimit publik qoftë me trupa ndriçues, ndërrimin e kablllove të ndryshme apo edhe ndërrimin e shtyllave të ndryshme.

Drejtoria e Inspeksionit

Në këtë Drejtori si probleme kemi ndërtimet pa leje e në veçanti në zonën e fshatit Orllan, përkundër punëve dhe angazhimeve që ka bërë Drejtorja e Inspeksionit prapë në atë pjesë kemi probleme dhe kemi qenë të detyruar që të marrim masa më drastike deri te rrënimi i disa objekteve të cilat i kanë shkelur të gjitha kriteret e përcaktuara ligjore. Po ashtu kjo Drejtori ka vazhduar punën e saj në kontrollimin e barnatoreve me qëllim të verifikimit nëse të njëjtat respektojnë orarin e punës por edhe veprimtarinë e tyre. Kemi pas inspektime të ndryshme në fushën e ambientit, pastaj inspektime të ndryshme që kanë pas qëllime vetëdijesuese për ruajtjen e ambientit dhe hapësirave tjera gjelbëruese, gjithashtu ka pas edhe

inspektime të ndryshme sa i përket keqpërdorimit të ujit të pijes, inspektimeve në rrjetin e kanalizimeve, janë kryer punë sa i përket lirimit të hapësirave publike që janë shfrytëzuar pa pëlqime paraprake, janë bërë inspektime të cilat lidhen me transportin rrugor dhe orarin e lëvizjes së tyre si dhe janë bërë evidentime të cilat lidhen me fushën e ndërtimitarisë. Është bërë identifikimi dhe ndalimi i objekteve ndërtimore pa leje, rrënimi i objekteve pa leje.

Drejtoria e Bujqësisë Pyltarrisë dhe Zhvillimit Rural

Ka realizuar një numër të projekteve të ndryshëm siç është përkrahja e 40 fermerëve me nga 1400 fidanë të mjedrës, shpërndarjen e 108 mëshqerrave për fermerët përfitues, furnizimin dhe montimin e 152 serave për fermerët, shpërndarja e mjeteve bujqësore për fermerët përfitues me kultivator dhe 37 shpërndarëse të plehut, shpër 36 makinave mjelëse, 20 spërkatësve me bosht, 20 kositësve të barit, 20 frezave të dheut, 10 mbledhëseve luledielli, 10 laktofrizëve për blegtorët tanë. Është bërë furnizimi dhe montimi i serave të ndara për 96 m² për 50 fermer/e përfitues/e, në bashkëfinancim me organizatën e Katarit. Në proces është shpërndarja e mekanizmit bujqësor projekt ky i cili është duke u realizuar bashkërisht me organizatën e Katarit për ndarjen e 65 motokultivatorët me frezë, kosë dhe rimorkio, ndarjen e 35 moto kultivatorëve me frezë dhe kosë, si dhe ndarjen e 70 moto kultivatorëve tjerë me pajisjet e tyre. Ka arritur të kryej punët dhe detyrat e saj sa i përket kompletimit të dokumentacionit për 2000 aplikues për pagesa direkte që janë bërë nga Ministria e Bujqësisë Pyltarrisë dhe Zhvillimit Rural, janë konfiskuar rreth 200m³, dru zjarri nga prerësit ilegal të pyjeve, sa për sqarim në opinionin publik ju keni pas mundësi ta shihni rastin në media se Komuna e Podujevës shet dru zjarri, por sa për sqarim drutë zjarri që konfiskohen nga prerësit ilegal të pyjeve nuk i lejohet Komunës që t'i ndajë për rastet sociale sepse ne kemi bërë kërkesë në Ministrinë përkatëse, madje kemi marrë vendim në Kuvendin Komunal që t'i ndajmë ato dru të konfiskuara për rastet sociale por një gjë e tillë nuk është e lejuar. Detyrimisht Komuna është e obliguar që këtë masë drusore ta shes përmes ankandit publik dhe kjo masë drusore është shitur me çmim prej 60 € për m³, mirëpo ne këtë masë drusore për shkolla ne e kemi ble me një çmim më të shtrenjtë, sepse nuk kemi të drejtë ligjore t'i marrim ato dru të konfiskuara në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe t'i shfrytëzojmë për nevojat e shkollave në bazë të legjislacionit në fuqi, e që konsiderojmë se është i pa logjikshëm sepse ne detyrohemi të blejmë masë drusore për rastet sociale ndërsa nuk mundemi të shfrytëzojmë masën drusore të konfiskuar nga ne. Ne në këtë Kuvend kemi marrë vendim për ndarjen e masës drusore për rastet sociale dhe ai vendim nga ana e Ministrive përkatëse është kthyer si vendim i jashtëligjshëm dhe pas këtij vendimi detyrimisht kemi qenë të detyruar që masën drusore të konfiskuar ta shesim përmes ankandit publik. Nga kjo Drejtori janë shqiptuar 233 fletëparaqitje kundërvajtëse për prerësit ilegal të drunjëve dhe 46 fletëparaqitje penale. Në pranverën e vitit 2023, është planifikuar ndarja e 223 koshere bletësh për fermerët bletarë, mirëpo është interesant ky projekt sepse nuk është realizuar siç është paraparë sepse është shpallë thirrja publike 2 herë dhe meqenëse ky projekt është i paraparë të realizohet por nuk besoj se në të ardhmen do të realizojmë projekte të tilla me vetë faktin se është rritur shumë numri i shoqërive të bletëve brenda territorit të Komunës së Podujevës dhe duke se kjo hapësirë nuk i jep mundësi më shumë rritjes së numrit të shoqërive të bletëve prandaj nuk ka edhe produktivitet nga kjo veprimtari për arsye se edhe shoqëritë e bletëve e kanë hapësirën e tyre punuese, për këtë arsye kemi menduar që vitin e ardhshëm t'i mbjellim disa sipërfaqe të tokës me bimë të cilat shfrytëzohen nga bletët në mënyrë që bletët të kenë mundësi më të mira për prodhimin e mjaltës. Viti 2023 do të jetë viti që do të bëhet ndarja e këtij subvencioni për këtë lloj të bimëve në mënyrë që qytetarët të kenë mundësi ta zhvillojnë këtë veprimtari dhe bletët e tyre të prodhojnë sa më shumë mjaltë.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik

Bashkërisht me BSKK-në, si rezultat i Memorandumit të bashkëpunimit është realizuar projekti për furnizimin me pajisje pune për 14 biznese në gastronomi, autolarje, rrobaqepësi, parukeri etj. Një punë të mirë mendoj se e ka bërë kjo Drejtori këtë vit në mesin e shumë

punëve të tilla mirëpo njëri prej tyre po e veçojmë e që është rregullimi i parkut të qytetit të Podujevës i njohur si Parku i Manchesterit. Ju e dini se në çfarë gjendje ka qenë ai park dhe tani ai ka marrë formën e tij siç e meriton, sigurisht nuk është e tëra kjo për arsye se në atë park ne do të investojmë edhe vitin e ardhshëm në mënyrë që ta krijojmë një ambient të këndshëm ku qytetarët tanë mund të dalin për rekreacion në kohën e lirë. Është bërë analiza e fizibilitetit për parkingun nëntokësor dhe besoj se DPUMM dhe Zyra prokurimit do të merren me këtë detyrë dhe ndoshta së shpejti do të bëhet edhe shpallja publike për ndërtimin e parkingut nëntokësor sepse ndërtimi i tij do të bëhet me partneritet publiko privat dhe presim investitorët potencial për realizimin e këtij projekti. Në bashkëpunim me organizatën Help është realizuar projekti “Gratë për Energi”, dhe janë shpërndarë pajisje për 22 përfituese në fushën e gastronomisë, rrobaqepësisë, dizajnit dhe prodhimit të tekstilit. Jemi në fazën finale për themelimin e ndërmarrjes publike lokale, roli i të cilës do të jetë për kryerjen e shumë shërbimeve brenda territorit të Komunës së Podujevës, të gjithë ne e dimë se kemi disa fusha ku gjithë përgjegjësinë e marrim ne si institucion mirëpo asnjëra prej tyre nuk janë në mbikëqyrjen tonë, shembull kemi kompaninë e pastrimit që nuk e menaxhojmë ne edhe pse kemi shpesh herë vërejtje nga ana e qytetarëve mirëpo kjo kompani menaxhohet në nivelin regjional, mirëpo barra dhe përgjegjësia e saj gjithmonë bie mbi ne. Në jemi pjesë vetëm e bordit të kësaj kompanie dhe nuk kemi asnjë kompetencë në menaxhimin e saj ose ta themi edhe për kompaninë rajonale të ujësjellësit, kurse të gjitha ankesat dhe përgjegjësitë rreth saj adresohen te ne e në realitet KRU Prishtina nuk jep asnjë përgjegjësi për Komunën e Podujevës. Në mënyrë që të kemi mundësinë që këto probleme t’i minimizojmë mendojmë ta themelojmë një ndërmarrje komunale që t’i ofrojmë shërbime të ndryshme qytetarëve. Me organizatën Eko Kosova Woman kemi realizuar projektin e fuqizimit ekonomik të grave në viset rurale me qëllim të krijimit të vendeve të punës dhe dhënies së prioritetit për angazhim në fushën e bujqësisë dhe nga ky projekt është bërë ndarja dhe montimi i 9 serave në sipërfaqe 100 m². Është realizuar panairi i artizanaleve dhe ditët e diasporës për promovimin e produkteve vendore, është hartuar Rregullorja e re për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, ku sa i përket orarit të punës së bizneseve për ditën e diele kemi pas kërkesa të ndryshme që dita e diele të jetë ditë pune dhe që po e njëjta ditë të jetë ditë pushimi për bizneset dhe më në fund u arrit një kompromis që kjo të jetë në vullnetin e bizneseve që të punojnë ose jo ditën e diele. Tani kjo çështje është më liberale por gjithherë duke i ruajtur të drejtat e punëtorëve që punëtorët të kenë ditën e pushimit ashtu siç përcaktohet me ligj dhe për këtë ne duhet të jemi në koordinim me Inspektoratin e Punës për ruajtjen e të drejtave të punëtorëve. Kemi nënshkruar një kontratë me Agjencinë Pyjore të Kosovës për marrjen në shfrytëzim të tokave pyjore konkretisht të pishat e fshatrave Kërpimeh, Shakovicë dhe besoj se këtë vit ne do t’i ndërtojmë disa shtigje të ecjes në mënyrë që qytetarët tanë të kenë mundësi t’i vizitojnë këto vende për rekreacion, ku përveç shtigjeve të ecjes ne do i rregullojmë edhe disa pushimore dhe disa shporta të mbeturinave. Është hartuar Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025, e cila tanimë është miratuar në Kuvend, gjithashtu ne kemi mbajtur një takim në Linc të Austrisë me bizneset e Lincit dhe është hera e parë që Komuna jonë është promovuar jashtë vendit. Në atë takim ne i kemi paraqitur të gjitha projektet e Komunës së Podujevës dhe kemi pas rastin që të takohemi me një numër të madh të bizneseve, madje kemi pasur rastin që të takohemi edhe me presidentin e parlamentit të Austrisë së Epërme, me qëllim që të kemi mundësi që të tërheqim investitor potencial për komunën tonë e me theks të veçantë ndërtimin e Zonës industriale në mënyrë që ta kemi mundësi që të krijojmë kushtet për investitorët e ardhshëm në Komunën tonë. Këtu para jush i prezantova disa punë të mira që janë realizuar por ka mundësi të kem harruar edhe disa prej tyre prandaj të dashur qytetar ju jeni këtu një lloj kujdestari për të gjitha punët që i kemi realizuar prandaj ne edhe presim propozimet, kritikën dhe sugjerimet e juaja. Jemi në dijeni që kërkesat dhe nevojat e juaja janë shumë më të mëdha por të gjithë e dimë se ky vit ka qenë vit i projekteve në vlerë prej miliona eurove në Komunën e Podujevës. Këtë e them se

rrallë herë ka ndodh që të kemi këso investimesh në Komunën tonë që nuk janë para të qytetarëve tanë por të donatorëve dhe për të investuar këta donatorë duhet punë angazhim dhe sjellje korrekte andaj besoj se këtë e kanë kuptuar edhe donatorët prandaj po mundohemi me të gjitha mundësitë dhe kapacitetet që kemi këto projekte t'i realizojmë. Unë besoj se edhe viti 2023 ka për të qenë vit që do të realizojmë punë të mira për qytetarët që do të vazhdojnë edhe në vitet 2024-2025. Unë pres sugjerimet e juaja, pse jo edhe vërejtjet të cilat janë domethënëse dhe mund të jenë të mirëseardhura për ne. Fjala është e juaja.

z.Tefik Bajrami, qytetar nga fshati Dumosh, ndër të tjera theksoi, është për tu përshëndetur puna për ndërtimin e çerdheve në Komunën tonë mirëpo kam një kërkesë në qoftë se është e mundur që edhe fëmijët e fshatit Dumosh të shkojnë në çerdhen e fshatit Batllavë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, ne me z.Tefik Bajrami kemi pas një bashkëpunim të mirë dhe këtë vit planifikojmë ndërtimin e një projekti në fshatin Dumosh për ndërtimin e objektit të ri shkollor të financuar nga Komuna e Podujevës, projekti do të jetë i njëjtë me atë të shkollës së fshatit Ballofc dhe besoj se brenda hapësirave të atij objekti të ri do të kemi kushte edhe për sigurimin e hapësirave për çerdhe të re për shkak se numri i nxënësve mund të mos jetë shumë i madh dhe nuk do të ketë nevojë për ndërtimin e një objekti të ri për çerdhe. Ne të gjithë e shohim më shumë si problematikë mirëmbajtjen e objekteve shkollore se sa ndërtimin e tyre andaj unë mendoj se brenda objektit të ri shkollor do të ketë hapësirë të mjaftueshme edhe për nxënësit e fshatit Dumosh.

z.Tefik Bajrami, tani po flas në emër të shoqatës humanitare Dumoshi dhe jemi në bashkëpunim me Komunën, ku jemi duke punuar që në vitin 2023 të rregullojmë fushën sportive në fshatin Dumosh dhe me hapësira tjera gjelbëruese, shpresoj dhe besoj se do të kemi mbështetje dhe participim nga ana e Komunës sepse ne jemi shoqatë e re, kemi disa anëtarë që na kanë ndihmuar prandaj shpresoj që ta kemi përkrahjen e juaj si institucion.

z.Sadat Murturi, banor nga fshati Lupç i Poshtëm, ndër të tjera theksoi, aktiviteti ynë si qytetar është i vogël por sa e shohë unë, sa kam parë në fshatin tim ekziston një mungesë e madhe apo një lidhje në mes të fshatrave dhe Komunës, e them këtë se mungon një lidhje sa i përket përfaqësimit sepse të gjithë ne e dimë se njësia e fshatit i ka disa obligime të përfaqësimit. Ne kemi disa probleme në fshat që është dashur të diskutohen me kohë mirëpo njësia e udhëheqjes së fshatit duhet të angazhohet më shumë e jo çdo herë të vijë në takime banorët e fshatit dhe t'i paraqesin kërkesat dhe nevojat e tyre sepse kjo është detyrë e kryesisë së fshatrave. Memorialet nuk e di se kush i menaxhon mirëpo kam një kërkesë sa i përket shtëpisë së bacës Adem Demaçi që së paku të krijohen kushte për vizitë të asaj shtëpie dhe të dinë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës se Adem Demaçi ka qenë nga Llapi kur dihet se baca Adem Demaçi ka marrë çmimin Saharov. Sa i përket memorialëve prapë e them se nuk e di se përgjegjësi e kujt është mirëmbajtja e tyre mirëpo në vizitën time të fundit në Kompleksin Memorial Zahir Pajaziti më 28 nëntor 2022, kam parë shumë mbeturina dhe me të vërtetë ai kompleks nuk e meriton një gjendje të tillë, gjithashtu edhe Kompleksi Memorial Afrim Zhitia kërkon një mirëmbajtje. Unë e përshëndes punën e juaj për ndërtimin e pushimores së heronjve tanë Ylfete dhe mentor Humolli në fshatin Lupç i Poshtëm, mirëpo kisha dashur që kjo pushimore të ndërtohet në vendin ku ka rënë heroina Ylfete Humolli, pse s'ka ndodh një gjë e tillë unë nuk e di. Pyetja ime e radhës është pse nuk ndërtohet një park në zonën e liqenit të Batllavës për qytetarët e llapit. Sa i përket transportit të nxënësve dhe inspektimit të komunës desha ta di se si janë raportet në respektimin e të drejtave të nxënësve dhe të drejtave të punëtorëve.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, unë po i përgjigjem pyetjeve tuaja mirëpo disa nga përgjigjet do i merrni nga Drejtorët e Drejtorive përkatëse. Sa i përket lidhjes apo funksionimit mes njësive të fshatit dhe Komunës mund t'ju them se ky problem nuk qëndron vetëm në fshatin Lupç i Poshtëm por është problem i përgjithshëm, ne kemi ende disa kryetar të përherëshëm që ka disa prej tyre që e quajnë vetën kryetar e disa jo e kjo varet nga situata ku ata ndodhen por ky është një proces që nuk ka ec e është dashur kohë më parë të përfundoj

por që ka problemet dhe specifikat e tij. Ne si Komunë kemi miratuar Rregulloren për organizimin e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës por sipas kësaj Rregulloreje kemi të përfaqësuar më shumë se 3 fshatra në një këshill prandaj sipas Rregullores nuk është e mundur që çdo fshat ta ketë përfaqësuesin e tij sepse është i kufizuar numri i këshillave të fshatrave sipas legjislacionit në fuqi, për këtë sqarime të hollësishme mund të na jap znj. Antoneta Ejupi Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës.

znj. Antoneta Ejupi, Drejtoreshë e DA, theksoi, lidhur me pyetjen sa i përket këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës ekziston një udhëzim administrativ në bazë të cilit është nxjerrë edhe Rregullorja këtë vit dhe vendimi për formimin e komisionit për koordinimin e procesit të këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës. Për shkak të numrit të limituar të këshillave të fshatrave ne jemi detyruar që disa fshatra të përfshihen në një këshill lokal, përfshirjen e këshillave e kemi bërë duke marrë parasysh afërsinë ndërmjet fshatrave, numrin e banorëve dhe elemente të tjera. Nga Ministria përkatëse jemi duke e pritur konfirmimin e ligjshmërisë që ka të bëjë me vendimin e kuvendit për formimin e komisionit për koordinimin e procesit të këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës, që të kemi mundësi të fillojmë me punët në terren për formimin e këshillave. Po ashtu kemi paraparë edhe platformën online ku çdo qytetarë do ta ketë mundësinë t'i paraqesë drejtpërdrejtë kërkesat dhe nevojat e tyre pa pasur nevojë që të vijnë dhe t'i paraqesin në mënyrë fizike në Komunë.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, sa i përket shtëpisë së bacës Adem Demaçi, Kompleksit Memorial Zahir Pajaziti, memorialit të Ylfete Humollit dhe obeliskut Afrim Zhitia, komplekset memoriale menaxhohen nga Agjencia për menaxhimin e Komplekseve Memoriale, andaj nuk janë në domenin e Komunës. Sa i përket investimit që është bërë për kompleksin e Ylfete Humollit, ky është investim i Agjencisë që i menaxhon dhe i mirëmban komplekset memorialë, kurse ne kemi investuar vetëm te ndriçimi publik i këtij memoriali dhe këtë investim e kemi bërë në bazë vullnetare sepse kemi dashur të bëhemi pjesë e projektit, përndryshe komplekset nuk menaxhohen nga ne. Njoftoj opinionin publik se këtë vit do të bëhet përrurimi i bustit të bacës Adem Demaçi në qytet ku së shpejti do të caktohet edhe lokacioni i vendosjes së bustit dhe këtë do e realizojmë goftë përmes një vendimi të Kuvendit apo përmes ndonjë vendimi të Ekzekutivit, projekt ky i financuar nga Komuna e Podujevës. Sa i përket lokacionit për rregullimin e kompleksit së Ylfete Humollit sigurisht aty ka probleme pronësore pse nuk është vendosur kompleksi në vendin ku ka rënë heroikisht heroina Ylfete Humolli. Sa i përket hapësirës për shtëpinë e bacës Adem Demaçi, duhet t'i adresohemi Agjencisë për menaxhimin e memorialëve që këtë shtëpi ta fusin në listën e monumenteve të mbrojtura me ligj në mënyrë që pastaj të kemi mundësi të investojmë në të. Lidhur me kërkesën që një pjesë/zonë e fshatit Orllan të kthehet në qendër rekreative, realisht kjo zonë është rekreative por tani në atë zonë përpos rekreacionit janë zgjeruar edhe disa biznese në mënyrë të kundërligjshme dhe me një vendim të Qeverisë të viti 2013, ajo zonë është shpallur zonë e mbrojtur dhe si e tillë është e ndarë në tri zona të mbrojtura me ligj ku në zonën e parë dhe zonën e dytë tërësisht janë të ndaluara ndërtimet kurse në zonën e tretë brenda kushteve të caktuara mund të bëhen ndërtime banimi. Sa i përket rekreacionit normalisht se çdo aktivitet që zhvillohet dhe nuk e cenon zonën e cekur sipas vendimit përkatës janë të lejuara dhe nuk kanë pengesa. Këtë vit ne kemi pasur një diskutim me zip line, është një projekt që e kemi ngritë si problem me swis kontaktin dhe do të shohim mundësitë për të na ndihmuar rreth financimit dhe presin eventualisht të gjejnë një donator në mënyrë që të krijojmë diçka atraktive në atë zonë. Këtë zonë duhet ruajtur, ndërsa investimet duhet t'i bëjmë konform rregullativës ligjore në fuqi të cilën jemi të obliguar ta zbatojmë. Sa i përket të drejtave të fëmijëve dhe punëtorëve, për këtë edhe Qeveria e Republikës së Kosovës ka për qëllim rritjen e numrit të inspektorëve të punës. Në Podujevë i kemi dy inspektor të

punës të cilëve u kemi ofruar edhe një hapësirë publike – zyrë të cilën e shfrytëzojnë me të vetmin qëllim, mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve mirëpo duhet të jemi të vetëdijshëm se është numër i vogël i inspektorëve për komunën tonë. Këta inspektor menaxhohen nga niveli qendror dhe ne jemi duke pritur nga niveli qendror që të kemi një inspektim sa më thelbësor se sa që është tani.

Bahri Kastrati, përfaqësues i lagjes së Kastrateve në fshatin Pakashticë e Epërme, theksoi, dua të paraqes disa kërkesa apo ankesa të lagjes sonë. Nënvizoi, kemi bërë disa kërkesa për asfaltim, njëra është për një rrugë që është rrugë kryesore në gjatësi afër 180 m , kërkesa tjetër është për 3 rrugë dytësore njëra është afër 112 m, tjetra afër 70 m dhe e treta 100 m. Ne si lagje jemi më e anashkaluar në territorin e Komunës tonë, diku 300m jemi pa trotuar, trotuari është vetëm në rrugën kryesore. Kemi paraqitur disa herë kërkesa mirëpo nuk janë marr parasysh. Dua ta cekim se jemi e vetmja lagje pa ndriçim publik. Kërkesë tjetër kemi rregullimin sa i përket gropimeve në fshatin Kërpimeh të cilat po vështirësojnë kalimin.

Problem tjetër është sigurimi i ujit të pijshëm të shkolla në fshatin Kërpimeh. Pastaj kërkesë kemi edhe për sigurimin e transportit të fëmijëve. Kërkesë tjetër është që një pronë e kooperativës që është bërë vendqëndrim i qenve endacak të pastrohet. Në fshatin Zakut i kemi 3 gropime të cilat paraqesin pengesë për ne, gjithashtu këto gropa vazhdojnë deri te fshati Peran dhe për në fund kemi edhe një kërkesë për investim në fushën e futbollit në fshatin Kërpimeh.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, rruga Kërpimeh-Pollatë dhe gropimet nuk janë kompetencë e Komunës, është rrugë rajonale që është në mbikëqyrje të Ministrisë së Infrastrukturës edhe pse ne kemi intervenuar që këto gropa të mbyllën. Sa i përket shtyllave të KEDS-it nuk kemi ndikim ne, gjithashtu edhe për çështjen e pronës së kooperativës ne e kemi dërguar kërkesën në AKP sepse është në menaxhim të AKP-së, këto kërkesa i kemi bërë për fshatrat si Kërpimeh, Dumnicë dhe Orllan, për t'i rritur ato objekte ne do ta rregullojmë këtë hapësirë edhe pse nuk është detyrë e jona kjo është detyrë e AKP-së mirëpo neve nuk na është dhënë leja nga AKP. Sa i përket ujit të pijshëm në shkollën e përmendur nuk jam i informuar nga Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, mirëpo Drejtori do të shkojë në këtë shkollë dhe do të njoftohet nga afër me gjendjen. Sa i përket transportit të fëmijëve nuk jam i informuar për transportin e tyre se a janë të mbuluara shpenzimet për transport në atë pjesë por e di që kemi ndarë një shumë të mjeteve për transportin e fëmijëve në shumë fshatra. Gjithashtu edhe për palestrën në Kërpimeh do të bëjmë investime, ndërsa sa i përket urave në fshatin Pakashticë aty janë bërë disa ndërtime të urave.

z.Bahri Selimi, Drejtor i DSHPMSH, theksoi, se janë investuar 8,3 km trotuare, 1 km trotuar është e ndërtuar këtë vit në fshatin Pakashticë. Pritet të vazhdojnë trotualet që janë paraparë të ndërtohen afër shkollave por ndjej keqardhje që aty ka përfunduar mirëpo unë do ta shqyrtoj si problem sepse paraqet sigurinë për nxënësit. Sa i përket ndriçimit publik këtë vit nuk kemi ndarë buxhet për ndriçim publik mirëpo vitin tjetër besoj që do ta ndajmë. Sa i përket gropave në fshatin Kërpimeh pritët të rregullohen pasi që e kemi dërguar kërkesën në Ministri të Infrastrukturës. Investimet që janë bërë në fshatin Pakashticë janë 5 ura të ndërtuara, dhe 500 metra janë kanalizim i ri.

z.Leotrim Krasniqi, Drejtor i DPUMM, theksoi, sa i përket asfaltimit këtë vit është realizuar kontrata loto 1 me fshatra në gjatësi 3,4 km që përfshin pjesën dërmuese të fshatrave veriore, ku në fshatin Pakashticë janë investuar 300m, ndërsa në vitin 2023 pritët që fshati Pakashticë të ketë trajtim të veçantë për asfaltim.

z.Avni Fetahu, Drejtor i DA, theksoi, këtë shkollë e kemi gjetur me disa probleme, si dritaret, kaldaja. Duke u nisur nga ky parim kjo shkollë ka hyrë në projektin e ofiqiencës për vitin 2023, do të bëhet intervenim në këtë shkollë, sa i përket ujit të pijshëm ka ujë të pijshëm por jo të mjaftueshëm, por do ta hapim edhe një pus. Sa i përket transportit të fëmijëve e kemi parasysh si kërkesë edhe nga drejtori i kësaj shkolle dhe do të mundohemi ta zgjedhim si problem.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, përfaqësuesit të lagjes së Kastratëve në fshatin Pakashticë, i preferoj të kontaktojë Drejtorët e Drejtorive përkatëse, varësisht ku ka vërejtje apo shqetësime, sepse të gjithë ne jemi për në shërbim të gjithë qytetarëve. Të jeni i bindur se jam shumë i interesuar që askush të mos ndihet i anashkalluar. Të gjitha punët nuk jemi në gjendje t'i kryejmë përnjëherë, por jemi duke punuar me prioritete dhe besoj se edhe lagja e juaj do të jetë pjesë e dorës së pushtetit lokal dhe për këtë duhet të jeni të bindur, ndërsa sa i përket shkollës, Drejtori i DA do të merret enkas me atë çështje.

z. Osman Sylja, nga fshati Llapashticë, theksoi kërkesën për dy rrugë të fshatit. Nënvizoi, kërkesën e kam parashtruar para tri viteve dhe prapë e kam përsëritur. Fjala është për rrugën në drejtim të varrezave që lidhet me lagjet Latifi dhe Shabani, rrugë e cila është në gjendje shumë të keqe, ndërsa rruga tjetër është nga lagja e Poterëve deri te përmendorja e dëshmorit Bedri Ahmeti. Kanë ardhur dy zyrtarë dhe vetëm e kanë shikuar dhe më askush nuk është marrë me këtë punë. Jam në dijeni se janë punuar shumë punë edhe në nivel të Komunës dhe i mirëpresim. Nënvizoi, mendoj se këto dy rrugë është dashur të trajtohen me prioritet.

z. Rexhep Dauti, përfaqësues i fshatit Llaushë, theksoi, kam një kërkesë për dy rrugë të fshatit që janë lidhëse, fjala është për njërin ku në të dy anët është asfaltuar, ndërsa ka mbetur e pa asfaltuar pjesa në mes, ndërsa rruga tjetër është që lidhë të dy shkollat. Të dy rrugët kanë një gjatësi prej 1100 m. Çështje tjetër është transporti i nxënësve ku aktualisht është ndërprerë për faktin se tenderin për transportimin e nxënësve tani më e ka fituar një operator tjetër dhe ai nuk është duke kryer transportin e nxënësve. Janë 15 nxënës që vijnë në mësimin dhe duhet të ecin 4.5 km, pra kemi shumë vështirësi t'i dërgojmë dhe t'i kthejmë nga shkolla. Çështje tjetër kemi ndriçimin publik. Në atë pjesë ku është më se i nevojshëm, te pjesa e malit aty është ndërprerë edhe pse janë shtyllat e betonit. Po ashtu prej shkollës së re në fshat është i nevojshëm rregullimi i trotuarit. Unë përcjell edhe kërkesën e banorëve të lagjes të cilës i përkas që të na rregulloni rrugën e cila ka mbetur në gjatësi prej 640 m, rrugë e cila lidhë fshatrat Llaushë dhe Dobërdol.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, Theksoi, sa i përket një pjese të rrugës që ndërlidhet me fshatin Dobërdol, një pjesë e kemi rregulluar, kështu që ka mbetur edhe një pjesë tjetër. Besoj se këto që janë të rëndësishme dhe me prioritet do t'i trajtojmë vitin që po hyjmë, sepse e përmenda, do të kemi 4 milion euro buxhet më shumë dhe do të kemi mundësi për të investuar më shumë në infrastrukturë. Besoj që Drejtorët e Drejtorive përkatëse do të japin përgjigje lidhur me kërkesat dhe pyetjet e parashtruara.

z. Raif Osmani, lagja Jaholli, Dumnicë e Epërme, theksoi që nga fillimi i mandatit kam bërë kërkesë për rregullimin e një rruge prej lagjes deri te shkolla në fshatin Dumnicë të Epërme. Qeverisja e mëparshme ka shtruar me zhavorr një pjesë por se është dëmtuar. Transportuesi i nxënësve nuk mund të vijë deri në lagje për marrjen e nxënësve për shkak të rrugës së dëmtuar. Kemi bërë kërkesë disa herë dhe na është premtuar se për vitin 2023 mund të ndërmerret diçka. Çështja tjetër është për një deponi ilegale, ku edhe Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit ka qenë dhe ka vizituar atë vend. Vend deponia është një gropë e cila është shkaktuar për shkak të marrjes së materialit dhe është e mbushur me mbeturina. Drejtori ka premtuar se do të ndërmarrim veprime për mbylljen e gropës dhe largimin mbeturinave nga një kompani, por si duket ende nuk është ndërmarrë asgjë. Ajo pjesë është gravituar nga nxënësit dhe mund të ketë rrezik edhe nga qentë apo kafshët e egra.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, edhe për kërkesat e cekuar nga parafolësi besoj se Drejtori do të jap përgjigjet.

z. Fadil Gërguri, nga fshati Siboc, theksoi këtë vit është ndërtuar rruga e fshatit, por e keqja e asaj rruge ka mbetur jo nga kjo qeverisje lokale por nga ajo urë që është ndërtuar në dalje. Kanë qenë në projekt ndriçimi i fshatit dhe rregullimi i trotuareve dhe për këtë do i pyetja Drejtorët e Drejtorive, se deri ku ka shkua. Kam edhe një kërkesë për te rruga e varrezave, të paktën me rregullua me zhavorr. Për kryetarin e kam një kërkesë në aspektin sportiv lidhur me aeroportin sportiv Batllava. Sa për njoftim unë merrem me aeronautikë, dhe kam kam

ndërkombëtarizuar këtë sport gjatë periudhës 2005-2016, kurse jemi federata e vetme dhe klubi i vetëm llapjan që nuk kemi aeroport sportiv. Shumë herë ka qenë tendencë që aeroporti sportiv të dal në rajone tjera, andaj kam bërë kërkesa edhe më parë që aeroporti sportiv të mbetet këtu dhe çështja e statusit të aeroportit Batllava të shqyrtohet nga Komuna por nuk kemi marrë përgjigje. Tash kam një klub dhe kam fituar një projekt prej Bashkimit Evropian dhe na është dashur që atë projekt ta realizojmë në Prilep të Maqedonisë së Veriut, ndërsa ne kemi një aset nacional dhe nuk shfrytëzohet.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, për çështjen e aeroportit kam pas dy donatorë që kanë qenë të interesuar të investojnë, duke menduar se ajo është pronë komunale, mirëpo rezultoi se aeroporti ishte evidencuar pronë e Qeverisë së Kosovës. Këtë çështje e kam diskutuar me Ministrin e Ministrisë së Infrastrukturës. Personin e interesuar për investime të kësaj fushe e kam orientuar të shkojë në Qeveri dhe nuk kam informacione lidhur me këtë. Po të ishte pronë komunale do ta menaxhonim ne dhe do u ofronim mundësi për investime, sepse do ta futnim në Listën e veçantë të pronave komunale për dhënie në shfrytëzim.

z. Vehbi Podvorica, përfaqësues i fshatit Dumosh, theksoi, kam dy kërkesa, njëra është për rrugën që lidh fshatrat Dumosh-Sfeçël, uji është duke vërshuar rrugën mes fshatrave, dhe si pasojë ka raste edhe të aksidenteve me automjete gjatë tentimit të tejkalimit të ujit të grumbulluar. Nëse vazhdon kështu ajo rrugë do të dëmtohet brenda një kohe të shkurtër, kështu që duhet intervenuar. Kërkesa tjetër ka të bëjë për rrugën te lagja e Vokrollëve, është shumë e nevojshme të rregullohet. Nënvizoi, kemi vërejtje te Kompania "Pastrimi", ajo ka të caktuar ditën dhe kohën e mbledhjes së mbeturinave, mirëpo nuk është duke iu përmbajtur orarit.

z. Fahrudin Mahmuti, përfaqësues i fshatit Siboc, theksoi, unë vetëm desha të ju përgëzojë për punët dhe projektet e realizuara, ndërsa sa i përket kërkesave të komunitetit, ato do t'i paraqes në formë të shkruar.

z. Bahri Selimi, Drejtor i DSHPMSH, theksoi, do të fillojë me kërkesat e z. Osman Sylas, për rregullimin e dy rrugëve me zhavorr. Unë jam i njoftuar për këto rrugë dhe kam qenë në terren, njëra është te varrezat e cila u mundëson qarkullim më të mirë nxënësve, është rrugë e mbyllur dhe e cila duhet të hapet, por s'kemi pas ende mundësi të intervenojmë dhe ta fusim në projekt, mirëpo si kërkesë do ta shqyrtojmë së shpejti, ndërsa rruga tjetër e cila është prej lagjes së Poterëve deri te përmendorja e Dëshmorit Bedri Ahmeti, në këtë rrugë duhet bërë një kalesë apo duhet vendosur disa gypa fillimisht e pastaj të ndërtohet rruga, kjo është edhe arsyeja pse ka mbetur deri në vitin e ardhshëm. Sa i përket fshatit Llaushë, këtë vit nuk kemi pas projekt të ndriçimit publik, për arsye se ka qenë si pasojë e një projekti të vjetër, në të cilin ka pas ankesa, ku kemi qenë të detyruar të intervenojmë në atë projekt dhe si rrjedhojë është shpenzuar buxheti i këtij viti, ndërsa trotuari te shkolla nëse vlerësohet do ta fusim në kuadër të projekteve vitin e ardhshëm, mirëpo paraprakisht do të dalim dhe të shohim pasi që aty është një kosto bukur e madhe për shkak të gjatësisë. Te fshati Dumnicë, te deponia ilegale aty fillimisht kanë filluar të nxjerrin material guror nga kompania për realizimin e një projekti dhe sipas kërkesës së juaj kemi ndaluar punën e asaj kompanie, e cila ka konfirmuar se ka bërë rrafshimin e gropës. Në fakt është shndërrua në deponi pasi që projekti ynë për largimin e deponive të egra ka përfunduar. Megjithatë ne do të merremi me këtë rast. Te fshati Siboc, për ndriçim publik është e njëjta përgjigje sikurse për kërkesat tjera. Siboci i Epërm është ndriçuar më shumë. Ka qenë një lloj koordinimi me KEDS-in që Kompania të vendosë shtyllat e betonit, ndërsa ne të bëjmë ndriçimin publik sepse është marrëveshje që ndriçimi të vendoset në shtylla të betonit, ngase në shtylla të drurit nuk lejohet të vendoset, kështu që duhet pritur vendosjen e shtyllave. Ku janë vendosur shtyllat nga KEDS ne kemi vendos ndriçimin dhe kjo bëhet paralelisht. Sa i përket trotuareve, ato janë shtrirë deri poshtë. Rruga te varrezat është kërkesë e kahershme, mirëpo projekti i infrastrukturës së varrezave ka përfunduar, mirëpo do të bëjmë përpjekje për trajtimin e rrugës me zhavorr, ndërsa te rruga e re e fshatit rruga është realizuar, ndërsa një defekt që ne e kemi vërejtur pas realizimit vitin që

po hyjmë do të bëjmë një kalesë mbi gypat, në mënyrë që të mundësoj sa më lehtë qarkullimin e ujit, mirëpo si duket problemi i ujit nuk buron vetëm nga aty, por duhet intervenuar edhe në disa pjesë të lumit që është i mbyllur.

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i DPUMM, theksoi, kemi dalë me komision në terren dhe kemi vlerësuar rrugët e nevojshme për asfaltim në fshatin Llapashticë, por kërkesat kanë qenë të shumta sa që përfshirja e të gjitha rrugëve lidhëse ka qenë e pamundur. Në fshatin Llapashticë (Poshtme & Epërme) gjatë këtij viti janë planifikuar për asfaltim 2.6 km rrugë, ku do të vazhdojë edhe një pjesë për vitin e ardhshëm. Gjatë debatit shumica nga ju paraqitët kërkesa për rrugët lidhëse, por të gjitha këto rrugë kanë një kosto pak më të lartë, ndoshta mundësia e tyre e realizimit shkon në një proces pak më të gjatë. Ne po ashtu në koordinim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë kemi kërkuar edhe mbështetje financiare prej 1.5 milion € për të na ndihmuar që t'i përfundojmë këto rrugë lidhëse të cilat janë mjaft të rëndësishme.

z. Avni Fetahu, Drejtor i DA, lidhur me atë që u theksua se nuk është duke u realizua transporti i nxënësve, pasi që operatori ekonomik qenka tjetër, e sigurisht qenka më i lirë se ai paraprak, unë do të interesohem cila është arsyeja, pse ai nuk është duke u realizua transportin dhe do u jap një përgjigje.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, nëse nuk keni ndonjë pyetje tjetër, unë ju falënderoj shumë për pjesëmarrje në këtë takim të përbashkët këtu edhe pse mendoj se po të ishte një numër më i madh i pjesëmarrësve do të ishte më mirë, sepse do të merrnim edhe shumë kërkesa tjera, por edhe sugjerime tjera për punën tonë apo ndonjë vërejtje eventuale për ndonjë lëshim që është bërë në punën tonë gjatë kësaj periudhe njëvjeçare. Besoj se takimet dhe kontaktet tona do t'i kemi të përditshme çoftë nëpër Drejtori, çoftë te zyra ime si Kryetar Komune, andaj mos hezitoni, sepse nuk përmbillet çdo gjë sot në këtë takim, andaj vazhdoni me kërkesa dhe ato të jenë korrekte dhe të nevojshme dhe në të vërtetë që zgjedhin problemet e qytetarëve. Të bëhen përpjekje maksimale për ikje të kërkesave individuale, të jenë të interesit më të gjerë. Nuk po them se ato individuale nuk mund të kërkohen, por të krijojmë një lloj prioritizimi të projekteve. Unë e di se kërkesat janë shumë më të mëdha sesa mundësitë financiare.

Nëse nuk ka tjerë të interesuar të marrin fjalën, e përmbylim takimin duke ju falënderuar shumë për kontributin e dhënë në këtë debat publik, për pyetjet dhe sugjerimet e dhëna, si dhe për vërejtjet e paraqitura.

Mbledhja përfundoi në orën 12.45

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr. 02-060/04-0103723/22
Podujevë, 22.12.2022**

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**